



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.29.1-2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË**  
**KAMENICËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015**

**Prishtinë, qershor 2016**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kamenicës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Udhëheqësi i Ekipit Ardita Salihu, anëtarja Cyme Hoxhaj dhe anëtarja Valbona Pllana.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	29
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	30
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	33


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Kamenicës (më tutje: komuna) për vitin 2015, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ne dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet e Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 06.10.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih shtojcën I të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

“Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes” sepse pasuritë në vlerë 465,000€ nuk ishin përfshirë në regjistrin kontabël të pasurive si dhe shpalesjet për llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar për 374,620€.


Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në kapitulli 1.2 i këtij raporti.

## Konkluzioni i përgjithshëm

Detajet e paraqitura në këtë raport, pasqyrojnë konkluzionin tonë të përgjithshëm, si vijon:

Komuna ka bërë përpjeke për adresimin e rekomandimeve tona dhe ushtron kontrolle në pjesën më të madhe të sistemit të kontrollit të brendshëm, por ende ekzistojnë disa fusha ku dobësitë janë të pranishme.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



### **Përgjigja e Menaxhmentit për auditimin 2015**

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, do ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

# 1 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar, për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.2 Opinioni i Auditimit

### PËR KOMUNËN E KAMENICËS

#### OPINIONI I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31.12.2015, të cilat përfshijnë 'Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme', 'Pasqyra e Krahimit të shumave Buxhetore me Aktuale', Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Vjetore Financiare dhe Shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën Financiare të MF nr. 03/2013 për Pasqyrat Vjetore Financiare të organizatave buxhetore.

#### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të Pasqyrave Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë

përmbushë në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që janë marrë, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion.

### **Theksimi i çështjes**

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se Regjistri i Pasurive Fikse nuk konfirmon gjendjen e plotë të pasurive, pasi që nuk përfshinë blerjet aktuale dhe ndërtesën e pranuar donacion nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në vlerë 465,000€.

Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar për 374,620€. Si shkak i interpretimit të gabuar të Ligjit për faljen e borxheve, komuna ka larguar nga bilanci i të arkëtueshmeve edhe borxhet nga taksat në biznes, shfrytëzimi i hapësirës publike si dhe garazhave. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare**

Menaxhmenti i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Personat e ngarkuar me qeverisje, si: Kryetari i Komunës, drejtorët, mbajtësit e buxhetit dhe zyrtarët financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për Pasqyrat Vjetore Financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse Pasqyrat Vjetore Financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-të do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritët që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre Pasqyrave Vjetore financiare.



Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

### 1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

#### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit të datës 06.10.2015, janë identifikuar dy rreziqe për PVF-të. Këto janë rreziqe të keqdeklarimet materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Njëri prej tyre ka të bëjë me prezantimin e pagesave nga palët e treta. Ky rrezik nuk është materializuar sepse komuna i ka prezantuar në PVF këto pagesa.

Rreziku tjetër kishte të bëjë me nënvlerësimin e shpalosjeve të pasurive kapitale në PVF, rrezik ky i cili është materializuar, sepse nga menaxhmenti nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për të adresuar këtë. Pasuri në vlerë mbi 465,000€ (pasuri të trashëguara, blerje aktuale, etj.) nuk janë përfshirë ende në librat kontabël.

### 1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me kërkesat buxhetore;
- Raportimet tremujore në Kuvendin Komunal; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportimin e progresit të investimeve kapitale mbi 10,000€.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne kemi identifikuar mos pajtueshmëritë në vijim:

- ZKF nuk ka raportuar për progresin e investimeve kapitale; dhe
- Nga buxheti për projekte kapitale janë shpenzuar shuma që nuk i takojnë kësaj kategorie dhe si të tilla kanë shpie në keqklasifikime të pagesave.

Draft PVF-të fillimisht përmbanin disa gabime materiale. Pas rekomandimit tonë, pjesët ku ka qenë e mundur të intervenohet janë korrigjuar mirëpo pasqyrat ende përmbajnë disa gabime si:

- Neni 13, raporti i ekzekutimit të buxhetit – buxheti final i donacioneve ishte nënvlerësuar për 11,967€. Shuma e paraqitur ishte 22,000 derisa duhet të jetë 33,977€;
- Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investime kapitale (IK) kishte bërë pagesa 86,000€ për mallra dhe shërbime (MSh) dhe subvencione. Fjala është për shërbimet dhe furnizimet, si: trajtimi i qenve endacak, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese, mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror, kompjuterë nën 1,000€. Vlen të sqarohet se shuma prej 81,554€ ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 për investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushnin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF;
- Shënimi 29: Pasqyra e obligimeve ishte mbivlerësuar për 14,100€;
- Shënimi 31 pasuritë jo financiare kapitale është nënvlerësuar për 465,000€; dhe
- Shënimi 35: Të arkëtueshmet (LI/ A) ishin nënvlerësuar për 374,620€.

## 1.5 Rekomandimet

**Rekomandimi 1 Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rrezikun domethënës për pasuritë. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.

**Rekomandimi 2 Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të sigurojë se ZKF raporton në mënyrë sistematike mbi progresin e IK-ve. Aty ku është e nevojshme, duhet të azhurnohen projektet në programin e IK-ve, në mënyrë që kërkesat e ardhshme buxhetore të jenë bërë në bazë të nevojave reale për investime.

## 2 Qeverisja

### 2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të mbështeten nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

### 2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes në komunë, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut, zbatimin e objektivave strategjike dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi praninë e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi dhe cilësinë e raportimit menaxherial.

## 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të komunës ka rezultuar në 18 rekomandime. Ky raport është diskutuar në Kuvendin Komunal, më datë 29.07.2015. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet.

Deri në përfundimin e periudhës së auditimit 2015, gjithsej 5 rekomandime janë implementuar, 9 janë adresuar dhe janë në proces të implementimit si dhe 4 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

---

### Çështja 1 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar, sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.
- Rreziku** Dobësitë e përsëritura të kontrolleve të menaxhmentit në sistemet financiare dhe fushat tjera të veprimtarisë kanë rezultuar në:
- planifikim dhe ekzekutim të dobët të buxhetit;
  - menaxhim të dobët të qiradhënies së pronave komunale;
  - justifikim të pamjaftueshëm të subvencioneve të shpërndara;
  - mbi/nën vlerësim të shpalosjeve në pasqyra; dhe
  - disa dobësi në qeverisjen e përgjithshme.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

## 2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave (MF) ka hartuar një listë të detajuar të vetëvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF. Më poshtë, ne kemi përmbledhur gjetjet tona për komunën. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

## Çështja 2 – Lista kontrolluese e vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

### E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.2;
2. Komuna ka hartuar Planin Zhvillimor Urban, Planin Zhvillimor Komunal si dhe Planin për Eficiencë të Energjisë. Në këto dokumente strategjike nuk janë të përcaktuara në tërësi kostot financiare për zbatimin e objektivave. Gjithashtu, nuk janë hartuar plane veprimi për adresimin e rekomandimeve. Kjo është vërtetuar edhe me përgjigje negative në pyetësorin e vetëvlerësimit/rrijdhimisht me notë të ulët;
3. Në vitin e kaluar ne kemi dhënë rekomandim për planifikim më cilësor sa i përket llojeve të prokurimit, në mënyrë që të shmangen ndarjet e tenderëve. Tashmë është vendosur një lidhje në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit, por nuk është raportuar për progresin e investimeve kapitale. Përgjigja në vetëvlerësim ishte me notë të lartë, por ne konsiderojmë se komuna nuk ka qenë mjaft objektive në vetëvlerësim; dhe
4. Udhëheqësit e njësive përgatisin raportet tre mujore për Kryetarin dhe Kuvendin Komunal. Takimet mbahen në baza të rregullta, por nuk ka dëshmi në dispozicion për të konfirmuar se në këto takime përcaktohen formalisht hapat për të adresuar çështjet e ngritura;

Konsiderojmë se komuna nuk ka qenë vetëkritike dhe mjaft objektive në plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit

### Rreziku

Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

### Rekomandimi 4

Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Gjithashtu, sa i përket objektivave strategjike komunale, Kryetari duhet të caktojë ekip përgjegjës i cili harton planin e veprimit për rekomandimet e zbatueshme. Dokumentet e tilla nuk duhet të mbesin vetëm të shkuara në letër.

## 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar, për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

---

#### Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut – Prioriteti i mesëm

<b>E gjetura</b>	Pyetësi i vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka rikonfirmuar se komuna ende nuk ka identifikuar rreziqet të cilat do të kanosnin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.
<b>Rreziku</b>	Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla, nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
<b>Rekomandimi 5</b>	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhojë këtë proces dhe do të raportojë në baza të rregullta mbi rreziqet.

## 2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja 4 – Dobësi në Kontrolllet Menaxheriale – Prioriteti i mesëm

- |                      |  |
|----------------------|--|
| <b>E gjetura</b>     | Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo të plotë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth diferencave në buxhet. Raportimet aktuale të drejtorive tek menaxhmenti, nuk përmbajnë konkluzionet apo hapat e ardhshëm që duhet të ndërmerren në rastin e paraqitjes së problemeve. |
| <b>Rreziku</b>       | Kjo cilësi e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë e ka reduktuar aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ka ulur efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo edhe ka rezultuar me ekzekutim të ulët të disa kategorive të shpenzimeve dhe arkëtim të dobët të të hyrave. Ngjashëm, mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta.  |
| <b>Rekomandimi 6</b> | Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.   |



## 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB-së dhe një auditor. Si organ i pavarur këshillëdhënës për menaxhmentin si dhe mbështetës për NJAB, është i themeluar Komiteti i Auditimit të Brendshëm. Komiteti përbëhet nga anëtarë jo ekzekutiv të stafit komunal dhe puna e tyre gjatë këtij viti, ka qenë në përputhje me autoritetin e përcaktuar me statut të këtij Komiteti. Komiteti ka mbajtur katër takime në vitin 2015. Në procesverbalet e takimeve vërehet se është diskutuar edhe për rekomandimet e auditorit të jashtëm.

NJAB ka planifikuar të kryej nëntë auditime dhe nuk ka pasur devijime nga ky plan. Të gjitha auditimet janë përfunduar me kohë dhe kanë të bëjnë me:

1. Të hyrat nga taksat e biznesit dhe shfrytëzimi i pronave me qira;
2. Të hyrat nga Inspeksioni;
3. Të hyrat nga taksat për shfrytëzim të hapësirave publike;
4. Menaxhimi i pasurisë;
5. Shpenzimet për MSH në Drejtorinë e Shëndetësisë;
6. Shpenzimet për MSH në Arsim;
7. Prokurimi;
8. Tatimi në pronë; dhe
9. Të hyrat në Administratën e Përgjithshme.

NJAB ka bërë punë cilësore në dhënien e sigurisë në lidhje me funksionimin e kontrolleve të brendshme në komunë. Mostrat tona kanë treguar se raportet e përfunduara janë të dokumentuara sipas kërkesave standarde për kryerjen e auditimit, përfshirë këtu përcjelljen dhe raportimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Gjithashtu, vlen të përmendim se planifikimi i fushave për auditim është përpiluar bazuar në analiza të rrezikut, për secilën njësi komunale.

Menaxhmenti i komunës ka përpiluar planin për adresim të rekomandimeve të auditorit të brendshëm. Ky i fundit zbaton proces formal të përcjelljes së adresimit të rekomandimeve. Gjatë vitit 2015, AB ka dhënë gjithsej 35 rekomandime prej të cilave 12 janë adresuar plotësisht, 12 janë adresuar pjesërisht, derisa 11 nuk janë zbatuar apo ende kërkojnë kohë për tu adresuar.

Më tej, përmirësime janë vërejtur në këtë njësi. Rekomandimi ynë për përfshirjen e subvencioneve në planin e AB dhe zbatimin e një qasjeje të veçantë testuese, është adresuar.

Arsyeja pse ne nuk jemi mbështetur në punën e auditimit të brendshëm, për qëllime të reduktimit të punës sonë audituese, është mos përputhja e fushëveprimit kohor të AB me objektivat tonat për vitin 2015. Në të ardhmen, mund të konsiderohet një gjë e tillë, nëse AB fokusohet më shumë në vitin aktual.

### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Për komunën, planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit, monitorimi i subvencioneve dhe qiradhëniet mbeten fusha më shqetësuese. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi certifikimin e pagesave në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime, janë planifikimi dhe realizimi i buxhetit, procesi i menaxhimit të qiradhënieve si dhe menaxhimi i pasurive.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>7,731,551</b>	<b>8,399,209</b>	<b>7,816,036</b>	<b>7,680,836</b>	<b>7,516,199</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	6,745,118	6,931,709	6,900,558	6,955,289	6,573,824
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup> –	0	447,100	377,619	349,890	414,260
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	986,433	986,433	516,594	355,312	327,821
Donacionet e brendshme	0	15,533	4,465	2,345	118,294
Donacionet e jashtme	0	18,434	16,800	18,000	82,000

Buxheti final tejkalon buxhetin fillestar për 667,658€. Kjo është si rezultat i rritjes së Grantit Qeveritar prej 186,591€ për të mbuluar kompensimin e përvojës, donacioneve vendore dhe të jashtme si dhe të hyrave të bartura, në total prej 481,067€.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të pashpenzuara të Komunës në vitin paraprak dhe të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Në vitin 2015, janë shpenzuar 93% të buxhet final me një përmirësim prej 3% krahasuar me vitin 2014. Megjithatë, realizimi i buxhetit për kategori mbetet në nivel jo të kënaqshëm, dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>7,731,551</b>	<b>8,399,219</b>	<b>7,816,036</b>	<b>7,680,836</b>	<b>7,516,199</b>
Pagat dhe Mëditjet	6,405,668	6,644,471	6,609,654	6,054,477	5,245,011
Mallrat dhe Shërbimet	495,515	580,563	506,706	524,928	627,625
Shërbimet komunale	160,700	188,672	160,095	170,609	178,286
Subvencionet dhe Transferet	122,332	187,801	113,121	178,025	192,457
Investimet Kapitale	547,336	797,712	426,460	752,797	1,272,820

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për projekte kapitale gjatë vitit, vetëm 53% e buxhetit ishte shpenzuar. Arsyeja kryesore e kësaj ishte se buxheti për IK ishte planifikuar të shpenzohej në raport 20% nga granti qeveritar dhe 80% nga të hyrat vetjake (THV). Ngjashëm ishte edhe vitin e kaluar. Mos realizimi i projekteve kapitale prej 47% ishte rezultat i mos realizimit të THV. Por, këtu përgjegjësia mbetet mbi komunën në kontekst të përgatitjes së buxhetit dhe mënyrës së shpenzimit të THV;
- Rritja e shpenzimeve operative kryesisht në MSh (rreth 53,500€ kontrata në vepër, rritja e shpenzimeve në mirëmbajtje dhe riparime, administrata e mbi ngarkuar, dhe shpenzimet për vendime gjyqësore), ka absorbuar një pjesë të buxhetit. Me qarkore buxhetore, Ministri i Financave u jep fleksibilitet komunave në përgatitjen e buxhetit për kategori, brenda kufijve të buxhetit të organizatës, përjashtuar këtu pagat dhe mëditjet. Prandaj, me një qasje më konstruktive në përgatitjen e buxhetit, një gjë e tillë do të mund të përmirësohej në dy-tre vitet e ardhshme; dhe
- Më tej, shqetësues është rënia e ekzekutimit të IK në raport me vitin e kaluar. Realizimi ishte për 43.3% më i ulët se viti i kaluar apo në shumë prej 326,337€.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës – pranimi krahas buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	986,433	986,433	759,595	749,986	642,124

## **Çështja 5 – Realizimi i dobët i buxhetit – Prioriteti i Lartë**

- E gjetura** Planifikimi i të hyrave gjatë vitit 2015 ishte realizuar 77%, gati në nivel të njëjtë me atë të vitit paraprak. Të hyrat vetjake, të barturat dhe inkasimi i vitit, nuk ishin shpenzuar në tërësi në dobi të qytetarëve. Të hyrat vetjake preferohet të shpenzohen në projekte kapitale. Komuna, 80% të planit të IK kishte planifikuar ta financoj nga THV, ndërkohë që ka shpenzuar një normë relativisht të lartë, (64%) të THV për shpenzime operative, si: kujdestaritë dhe shtesat, MSh si dhe S&T, derisa vetëm 36% ishin destinuar për projekte kapitale. Shpenzime totale të mbuluara nga THV ishin 894,213€, ndërkohë që si të hyra të pa shpenzuara në vitin 2016 ishin bartur 312,481€ (26%). Plan i ngjashëm është pasqyruar edhe në vitet e ardhshme në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët i tij do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm. Gjithashtu, koncentrimi i THV në financimin e shpenzimeve operative nuk sjellë përmirësim të shërbimeve për qytetarë.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike dhe janë identifikuar barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku mund të bëhen përshtatjet për reduktim të shpenzimeve operative, të njëjtat të rishikohen për koncentrim në projekte kapitale.

## 3.4 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit të tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

---

### Çështja 6 – Dobësi sistematike në prokurim – Prioritet i lartë

**E gjetura** Nga shqyrtimi i kontratave kemi identifikuar se në dy raste komuna ka shpërblyer me kontratë, operatorë ekonomik të pa përgjegjshëm. Rastet e tilla janë tek kontratat “Kanalizimi në qytet dhe fshatra-Lot 2” (8,480€) dhe “Punimi i parkut prapa banesave në Kamenicë” (22,139€), ku operatorëve fitues i mungonin dëshmitë e kontributeve të dërguar në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) për pesë punëtorë, në tremujorin e fundit.

Për pagesat e mëposhtme, raportet e pranimi të nënshkruara nga komisionet përkatëse, nuk përmbanin shënime të detajuara mbi punët e kryera nga operatori: “Ndriçimi publik në qytet dhe fshatra” në vlerë 10,000€ dhe “Mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese” në vlerë 3,987€;

**Rreziku** Rastet e mësipërme tregojnë për dobësi në procesin e prokurimit. Prania e dukurive të tilla gjatë planifikimit dhe përzgjedhjes së operatorëve, nuk është në pajtim me rregullat e prokurimit, ndërsa pagesat e pa dokumentuara vënë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve/produkteve të pranuar.

**Rekomandimi 8** Kryetari të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen vendosur kontrole të shtuara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet në prokurimet e ardhshme.

## 3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### 3.5.1 Shpenzime tjera

---

#### Çështja 7 – Kontratat për shërbime të veçanta – Prioritet i lartë

<b>E gjetura</b>	Komuna, vazhdimisht angazhon staf me kontrata për shërbime të veçanta, madje edhe në pozita ku nuk kërkohet ekspertizë e veçantë, si zyrtarë për informim, roje pylli, zyrtarë kadastri, zyrtar ligjor etj. Sipas ligjit të shërbimit civil, kontratat e tilla duhet të bëhen për një afat jo më gjatë se gjashtë muaj. Gjatë vitit 2015 janë ripërtërirë nëntë kontrata që nga viti 2014. Gjatë këtij viti, për 15 punonjës janë paguar mbi 53,500€ në emër të këtyre shpenzimeve. Më tej, në tre kontrata theksohej se vazhdimi i kontratës bëhet deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit.
<b>Rreziku</b>	Shpenzime të tilla rrezikojnë të mos jenë reale me nevojat e komunës, buxheti të mos shpenzohet sipas qëllimit si dhe të mos diskriminohen kandidatët me rastin e zbatimit të procedurave të rekrutimit.
<b>Rekomandimi 9</b>	Kryetari duhet të sigurojë se kontratat për shërbime të veçanta përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, planifikohen drejtë dhe bëhen në pajtim me ligjin. Ne sugjerojmë që kjo praktikë të ndërpritet sa më parë.

## Çështja 8 – Menaxhim jo adekuat i autoparkut – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Ne kemi audituar 5 mostra të veturave të Administratës së Përgjithshme Komunale në lidhje me menaxhimin e të dhënave të kilometrave të shpenzuara dhe në përgjithësi autoparkut. Në fletudhëtimet e plotësuar, kemi vërejtur se vetura 06-507-CI ka udhëtuar mbi 30,000km në relacionet shtëpi-punë-shtëpi. Sipas rregullores së brendshme për përdorimin e automjeteve, nenit 11, të gjitha veturat e komunës (përveç asaj të Kryetarit) pas orarit të punës duhet të parkohen në parkingjet e komunës; dhe
- Më tej, në fletudhëtimet e veturës me targa 06Z-03-10, gjatë vitit 2015 rreth 2,700 km gjithsej, nuk janë evidentuar dhe nuk dihet ku ka qenë destinacioni i udhëtimit.
- Rreziku** Menaxhimi i dobët me përdorimin e automjeteve zyrtare përveç që rrezikon shpenzime të pajustificueshme, gjithashtu rrezikon keqpërdorimin e veturave zyrtare për qëllime private.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të rishikoj rastet e mësipërme dhe të merr masat e duhura. Gjithashtu, duhet të sigurojë se zyrtarët respektojnë në tërësi kërkesat e rregullores së brendshme për përdorimin e veturave zyrtare. Personat përgjegjës për mbikëqyrjen e autoparkut duhet të sigurojnë se automjetet zyrtare përdoren vetëm nga personat e autorizuar dhe me fletudhëtime të plotësuar dhe të aprovuara nga menaxhmenti i komunës.

### 3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive. Shpenzimet në paga gjatë vitit 2015 ishin 6,609,654€ apo 99% e buxhetit.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Komuna planifikoi buxhetin 187,800€ për S&T, ndërsa shpenzoi 113,120€ apo 60%. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të fermerëve, aktiviteteve kulturore, ndihma momentale si dhe subvencione për arsim jo formal të grupit të grave në komunë. Testimet tona kanë treguar mangësitë si vijon:

---

#### Çështja 9 - Mangësi në rregulloren e brendshme dhe justifikim i pamjaftueshëm i subvencioneve - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Vitin e kaluar kemi ngritur çështjen për mangësitë në rregulloren e brendshme ekzistuese, sa i përket shpërndarjes së subvencioneve në sektorin e bujqësisë. Komuna e ka draftuar, por ende nuk ka e proceduar për miratim rregulloren me ndryshimet e nevojshme.

Me rastin e subvencionimit të arsimit jo formal të grupit të grave, 46 prej tyre u ishin ndarë gjithsej 8,550€. Në vend që të merrej vendimi për lirimin e këtyre grave nga pagesa e tarifës së arsimit jo formal, dhe mjetet të dedikoheshin për shkollën ("Andrea Durrsaku") si ofruese e këtij shërbimi, komuna kishte bërë pagesat në llogari personale të përfituesve, për t'i deponuar pastaj ato në llogarinë e shkollës, ku edhe ofrohej arsimi joformal, respektivisht në llogari të buxhetit komunal. Ne kemi vërejtur se 15 nga përfitueset kishin hezitur vazhdimisht të kryejnë pagesat ndaj shkollës. Pas insistimit të shkollës, ky numër është zvogëluar dhe ka mbetur vetëm një person i cili nuk ka kryer pagesën për arsimin jo formal.

Kryetari mori vendim për subvencionimin e projektit "Lulëkuqet e Prillit" në vlerë 4,530€, jo në pajtim me rregulloren, sepse shumat mbi 2,000€ duhet të aprovohen në Kuvendin Komunal; dhe

Me vendim të Kuvendit Komunal, KF "Kamenica" iu ndanë 3,000€. Në kërkesën e klubit për këtë subvencion nuk ishte bashkangjitur ndonjë plan konkret se ku do të shpenzohen mjetet. Përkundër kërkesës nga Drejtoria e Kulturës për raportim të shpenzimeve, klubi nuk ka sjell raporte kthyesë për të dëshmuar rregullsinë e shpenzimeve.

**Rreziku** Mangësitë e tilla në menaxhimin dhe dhënien e subvencioneve rrisin rrezikun që fondet të mos shpenzohen në pajtim me qëllimet e dedikuara.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të sigurojë se procedura efektive zbatohen me rastin e dhënies së subvencioneve si dhe respektohen kriteret e rregullores. Sa i përket subvencioneve për arsimin jo formal, të ushtrohet mbikëqyrje e vazhdueshme për t'u siguruar se mjetet derdhen në llogarinë e buxhetit komunal. Gjithashtu, të bëhet monitorim i vazhdueshëm i shpenzimeve të subvencioneve në mënyrë që të sigurohen raporte të vlefshme për arsyeshmërinë e shpenzimeve.

### 3.6 Të hyrat

Këtë vit inkasimi i të hyrave vetjake ishte 759,595€ apo 9,609€ më i lartë se viti paraprak. Megjithatë, tatimi në pronë si kategori dominuese e të hyrave vetjake ka shënuar rënie krahasuar me vitin e kaluar (për 9,951€). Komuna e arsyetonte këtë rënie me vendimin e Qeverisë për faljen e borxheve, me ç'rast qytetarët kanë filluar të tregojnë një lloj rezistence ndaj përgjegjësisë për pagesën e tatimit në pronë. Mangësitë në këtë kategori ishin:

---

#### Çështja 10 – Dobësi në qiradhëniet komunale – Prioritet i lartë

<b>E gjetura</b>	<p>Përkundër rekomandimit tonë, për përmirësim të menaxhimit të procesit të qiradhënieve, dobësitë vazhdojnë edhe këtë vit:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Ka raste ku si bazë ligjore për dhënien e pronave në shfrytëzim me qira janë vetëm aktvendimet e komunës, pa ndonjë kontratë që specifikon kushtet e përgjithshme dhe të veçanta;</li><li>• Qiramarrësit shfrytëzojnë pasuritë komunale pa kryer obligimet e qirasë; dhe</li><li>• Komuna nuk ushtron mekanizma adekuat për mbledhjen e të hyrave nga qiraja.</li></ul>
<b>Rreziku</b>	<p>Mangësitë e identifikuar në menaxhimin e qiradhënieve komunale rrisin rrezikun që komuna asnjëherë të mos i arkëtojë tarifat e qirasë si dhe rrit rrezikun potencial për keqpërdorime. Praktikë e tilla gjithashtu kufizojnë konkurrencën dhe mund të diskriminojnë të interesuarit potencial për shfrytëzim të pronës komunale.</p>
<b>Rekomandimi 12</b>	<p>Kryetari duhet të mbikëqyrë në mënyrë të veçantë procesin e të gjitha qiradhënieve komunale, me theks të veçantë në nevojën për mbështetje me bazë kontraktuale të çdo prone të lëshuar me qira. Komuna duhet të jetë më rigorozë në mbledhjen e borxheve nga qiraja, ndërsa obliguesve që nuk kanë paguar qiratë, t'iu ndërpritet mundësia e shfrytëzimit të mëtejshëm të pronave.</p>



## Çështja 11 – Planifikim jo adekuat i të hyrave vetjake – Prioritet i mesëm

### E gjetura

Me rastin e planifikimit të të hyrave, ka raste kur komuna nuk bën një vlerësim të përshtatshëm të kapaciteteve inkasuese dhe trendeve të viteve të kaluara të të hyrave. Tek planifikimi i të hyrave nga lejet e biznesit, të hyrat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, lejet e ndërtimit dhe taksat nga inspektimi, ekziston një shkallë ambicioze e planifikimit dhe jo në përputhje me kapacitetin inkasues të komunës.

Nga analiza e tatimit në pronë, ne kemi vërejtur dy raste ku ngarkesat për tatim në pronë i janë faturuar edhe institucioneve shkollore për vite me radhë. Fjala është për shkollën Skënderbeu (ngarkesa 616€ derisa borxhi total kishte arritur në 6,306€) si dhe shkollën 9 Maji (ngarkesa 186€ derisa borxhi ishte 1,901). Kjo bie në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili liron nga tatimi Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjatë rishikimit të planit për tatimin në pronë propozuar nga menaxheri i tatimit në pronë, kemi identifikuar se nuk është përfshirë në plan verifikimi i 1/3 së territorit për rivlerësim të pronave, siç kërkohet me Udhëzimin administrativ nr. 03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave të tatimit në pronë.

### Rreziku

Planifikimi linear, pa mbështetje në analiza të trendeve dominuese, ekonomike si dhe potencialit në bazë të njësisë dhe popullatës, paraqet bazë për planifikim të dobët të buxhetit. Më tej, tarifimi kundërligjor i institucioneve, rritë shkallën e llogarive të arkëtueshme në vazhdimësi, pasi që arkëtimi i tyre nuk mund të bëhet. Më tej, mos verifikimi i objekteve mund të shkaktoj humbje financiare për komunën.

### Rekomandimi 13

Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e rishikimit të buxhetit bëhet përshtatje e planifikimit të të hyrave, bazuar në trendin e inkasimit të periudhave të mëparshme dhe kompleksitetin e operacioneve ekzistuese. Gjithashtu, të verifikohet legjitimiteti i faturimit të objekteve në regjistrin e tatimit në pronë dhe të dhënat të azhurnohen sipas kërkesave ligjore mbi pronën e paluajtshme. Më tej, zyra e tatimit në pronë të shfrytëzoj të gjitha burimet për verifikim të pronave.

## 3.7 Pasuritë dhe detyrimet

### 3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna ka bërë përmirësime sa i përket regjistrimit të pasurive komunale si tokat dhe ndërtesat e trashëguara, sipas rekomandimit të dhënë vitin e kaluar. Vlera e pasurisë në vitin 2014 ishte 5,233,000€ ndërsa në fund të vitit 2015 vlera arrinte në 58,861,092.

---

#### Çështja 12- Regjistra jo të plotë të pasurive komunale- Prioritet i lartë

**E gjetura** Katër mostra të blerjeve kapitale në vlerë 39,000€ nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë. Gjithashtu, kemi vërejtur se objektet si ish barnatorja e vjetër e qytetit (lokal i lëshuar me qira) dhe objekti për banim social (të dhuruar nga Ministria e Punës, në vlerë 394,962€) nuk janë të përfshira në regjistrë;

Kjo ka ndodhur në mungesë të certifikatave pronësore që duhet të gjenerohen nga Kadastri dhe në përgjithësi mungesa e komunikimit mes departamenteve dhe zyrtarit të pasurisë.

Objektet e trashëguara janë regjistruar në bazë të një raporti të vlerësimit të bërë nga komisioni i vitit 2003. Ky regjistër nuk është azhurnuar që nga ajo kohë dhe si pasojë nuk dihet vlera e drejtë e këtyre objekteve pasi që mund të vë në mëdyshje ekzistencën e disa objekteve ndër vite. Zyrtari i pasurisë nuk kishte regjistruar të gjitha objektet e këtij raportit me arsyetimin se disa nuk ekzistojnë. Por, nuk ekziston një raport i ndonjë komisioni që vërteton mos ekzistencën e tyre. Për më tepër, përllogaritja e zhvlerësimit ishte bërë në formë manuale dhe nuk kemi marrë siguri nëse kalkulimi i zhvlerësimit është bërë për çdo vit që nga regjistrimi i vitit 2003.

Projektet kapitale në vlerë 31,054€, e paguar gjatë vitit 2014, e cila ishte pjesë e rekomandimit tonë, edhe këtë vit nuk ishin të përfshira në regjistrin e pasurisë;

Me vendim të Kryetarit të Komunës (01.12.2015) është formuar një komision i përbashkët për vlerësim dhe regjistrim të pasurisë komunale, derisa rregullorja 02/2013 përcakton që formohen komisione të ndara për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë. Më 27.01.2016, Komisioni kishte përgatitur raport për regjistrim të inventarit, dhe në bazë të këtij raporti ekzistojnë pasuri të cilat janë jashtë përdorimit. Bazuar në këtë, duhet të formohet një komision për vlerësimin e këtyre pasurive të identifikuar dhe të reflektohen në PVF.

Keqklasifikimet e shpenzimeve janë bartur gabimisht edhe në regjistra të pasurive, siç janë shpenzimet për trajtim të qenve endacak, subvencione për fermerë. Këto shpenzime nuk i plotësojnë kushtet të njihen si investime kapitale. Vlera ishte 22,780€.

Gjithashtu, regjistri i E-Pasuria nuk është i plotë sepse nuk përmban të gjitha pasuritë nën 1,000 nga sektori i shëndetësisë dhe arsimit.

---

**Rreziku** Regjistri jo i plotë i pronave vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, humben apo tjetërsohen. Regjistrimi i mangët dhe i pa saktë i pasurive të cilat nuk përmbushin kushtet për tu trajtuar si pasuri kapitale, bën që regjistri të jetë jo i besueshëm, dhe si rrjedhojë mund të ndikojnë opinionin e auditimit.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të formoj komisione për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjitha pasurive jo financiare si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Rezultatet e regjistrimit duhet të integrohen në një regjistër të vetëm për të gjithë sektorët. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e pasurive komunale të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores dhe mos konsolidimin e vlerës së pasurive.

### 3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Komuna ka të deklaruar shuma të konsiderueshme të Ll/A nga tatimi në pronë, taksa biznesi dhe qiraja në vlerë 1, 491,000€. Por, kjo shifër del të jetë e nënvlerësuar shkaku i mangësive si më poshtë:

#### Çështja 13 – Nën deklarim material i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna ka llogaritur shumë për faljen e borxheve të Ll/A nga taksat e biznesit, shfrytëzimin e hapësirës publike si dhe garazhave, gjithsej për 380,000€. Duke u thirrur në ligjin për faljen e borxheve, komuna ka larguar këtë shumë nga bilanci i Ll/A. Por, përveç tatimit në pronë, ky ligj nuk e rregullon faljen e borxheve për taksat tjera. Një gjë e tillë duhet të kalojë përmes Kuvendit Komunal.

Në anën tjetër, janë paraqitur 5,380€ Ll/A nga lejet e ndërtimit vetëm bazuar në lëndët ku rasti ka shkuar deri te plotësimi i kushteve ndërtimore dhe plotësimi i kushteve për dhënie e lejes së ndërtimit, por pa e faturuar ende kërkesin e lejes. Shumat e tilla nuk mund të konsiderohen ende Ll/A.

Marrë në tërësi, llogaritë e arkëtueshme janë rritur në krahasim me vitin e kaluar përveç tek lejet e ndërtimit dhe tatimi në pronë.

**Rreziku** Borxhet e pa arkëtuara zvogëlojnë aftësinë e komunës për të adresuar nevojat për shpenzime. Heqja e Ll/A, pa vendim të Kuvendit Komunal paraqet nënvlerësim të bilancit dhe mund të ndikojë në opinionin e auditimit.

**Rekomandimi 15** Kryetari duhet të shqyrtojë vjetërsinë dhe vlefshmërinë e borxheve individuale dhe të zbatojë një proces sistematik të trajtimit të atyre borxheve që konsiderohen të pa mbledhshëm duke i trajtuar të gjitha në mënyrë të veçantë, në Kuvendin Komunal.

### 3.7.3 Trajtimi i borxheve

Këtë vit, obligimet e pa paguara janë deklaruar në shumë 124,340€, ku paraqitet një rënie prej afro 37% me vitin e kaluar, të cilat arrinin vlerën 198,200€. Shuma e tillë e shpalosur, përbënte mangësi.

Ministri i Financave, ka aprovuar kërkesën e komunës, që borxhet të paguhen nga fondi i të hyrave të bartura nga viti 2014.

---

#### Çështja 14 - Shpalosje jo e drejtë e obligimeve - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Në obligime janë paraqitur edhe fatura të cilat i takojnë obligimeve të vitit 2016. Rrjedhimisht, obligimet janë mbivlerësuar për 14,100€.

**Rreziku** Shpalosja e pasaktë e obligimeve përveç që paraqet një pozitë jo reale financiare, kjo paraqet edhe bazë çorientuese për buxhetim të aktiviteteve vijuese financiare.

**Rekomandimi 16** Kryetari duhet të sigurojë se drejtorët vlerësojnë në baza mujore, të gjitha faturat e papaguara dhe në mënyrë formale raportojnë tek ZKF. Po ashtu, konfirmime formale duhet të sigurohen nga departamentet komunale se të gjitha faturat e papaguara i janë proceduar për pagesë shërbimit të financave.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

**(e shkëputur nga ISSAI 200)**

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë kedeclarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarime të, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuar	Të adresuara por jo të implementuar	Të pa adresuara
Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të identifikojë arsyet për dobësitë e identifikuar dhe të siguroj se proceset e rishikimeve nga menaxhmenti do të përmirësohen për PVF-të e vitit 2015 para se të dorëzohen në Qeveri. Keqklasifikimet e ndodhura të jenë objekt i një shqyrtimi të menjëhershëm.		Pjesërisht Në PVF edhe këtë vit ka pasur gabime në zërat e paraqitur (shih pjesën 1.4)	
Keqklasifikimet	Keqklasifikimet të janë identifikuar dhe shpalosur para se të dorëzohen PVF në Qeveri. Një proces i mirëfilltë planifikimi dhe ekzekutimi buxhetor, do të ishte masë e nevojshme për eliminimin e dobësive të tilla.		Pjesërisht Pjesa e shpalosjes së keq klasifikimeve nuk është bërë.	
(Shpalosjet e pasurive)	Të identifikohet veprimi i duhur për t'i adresuar dobësitë në menaxhimin e pasurive, në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë të pasurive në PVF-të e vitit 2015		Pjesërisht Janë regjistruar pasuritë e trashëguara por blerjet nuk janë regjistruar ende.	
Rekomandimet e vitit paraprak	Plan veprimi i rishikuar, për adresim të rekomandimeve të pa-adresuara të vitit 2013, së bashku me rekomandimet e 2014, të përcaktojë një orar të qartë të zbatimit të tyre.		Pjesërisht Nuk monitorohet formalisht zbatimi i rekomandimeve. Disa nga rekomandimet kanë mbetur të pa zbatuara.	

Qeverisja e mirë	Të zbatohen linja formale të raportimit me drejtorët ku do paraqiten rezultatet dhe shpenzimet për të gjitha aktivitetet kyçe. Të përpilohet regjistri i rreziqeve, të emërohet personi përgjegjës për menaxhimin efektiv të regjistrit si dhe të bëhet monitorimi adekuat. Gjithashtu, kryetari të sigurojë se Zyra Ligjore posedon kompetencën e mjaftueshme profesionale, dhe çështjet ligjore i administron me kohë dhe në mënyrën e duhur.		Pjesërisht Pjesa e menaxhimit të rrezikut ende nuk është adresuar.	
Buxheti	Të monitorohet në baza mujore performanca buxhetore dhe të identifikojë dhe adresojë problemin që ndërlidhet me planifikimet buxhetore, e në veçanti proporcionin e financimit të Investimeve kapitale 80% nga THV dhe 20% nga Granti Qeveritar.			Jo
Të hyrat	Eliminimi i neglizhencës së trajtimit të lejeve ndërtimore. Ndërtimi i evidentuar të monitorohet në mënyrë të veçantë për të mos cenuar rregullat e ndërtimit dhe shmangien e taksave.  Të delegohen përgjegjësitë për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së qiradhënive në mënyrë që të ofrohen të dhëna të hollësishme narrative dhe financiare mbi qiratë. Qiradhëniet të mbështeten me bazë të fortë kontraktuale.	Po		Jo
Shpenzimet përmes prokurimit	Planifikim i hollësishëm është i nevojshëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim. Projektet kapitale duhet të hartohen me kujdes të shtuar në mënyrë që të mos përsëriten dukuritë e tilla dhe gabimet në paramasa.			Jo

	Të shqyrtohen pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se situatat e tilla nuk do të përsëriten. Rastet ku ka vonesa në ekzekutimin e punimeve nga operatorët ekonomik të aplikohen penalet sipas kontratës	Po		
Shpenzimet jo përmes prokurimit	<p>Të ndërmerren masa të një qeverisjeje të mirë në marrëveshjet e bashkëfinancimit përfshirë kërkesat e qarta të raportimit gjatë implementimit dhe monitorimit të projektit si dhe të raportohet në Kuvend.</p> <p>Kontratat për shërbime të veçanta përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, planifikohen drejt dhe bëhen në pajtim me ligjin</p>	Po		Jo
Paga dhe mëditje	Të bëhet një rishikim i orareve të kujdestarive në QKMF në mënyrë që të mos tejkalohet numri i orëve shtesë dhe të respektohet ligji i punës dhe planifikimi buxhetor.	Po		
Subvencione dhe Transfere	Subvencionimi të bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara me rregullore, dhe se përfitues të subvencioneve janë subjektet që prezantojnë programe atraktive që përmbajnë objektiva të qarta dhe me interes edhe për vet komunën. Kuvendi, gjithashtu, duhet të rishikojë përmbajtjen e rregullores së brendshme.		Pjesërisht Komuna ka draftuar rregulloren e re derisa sa i përket monitorimit të subvencioneve, ende ka lëndë që nuk kanë adresuar këtë.	

Pasuritë	Të formohen komisione kompetente për vlerësimin dhe inventarizimin e drejtë dhe të plotë të të gjitha pasurive jo financiare si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Procesi i regjistrimit të pasurive me vlera më të larta se 1,000€ në SIMFK, duhet të vazhdoj deri në regjistrimin përfundimtar. Zyrtari kompetent të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores dhe mos konsolidimin e vlerës së pasurive.		Pjesërisht Nuk është konsolidimi i plotë nga arsimi dhe shëndetësia.	
Llogaritë e arkëtueshme	Të shqyrtojë vjetërsinë dhe vlefshmërinë e borxheve individuale dhe të zbatojë një proces sistematik të trajtimit të atyre borxheve që konsiderohen të pambledhëshme (arsyeja duhet të dokumentohet dhe validohet). Të gjitha mjetet në dispozicion të shfrytëzohen, përfshirë edhe veprimet ligjore. Delegim i qartë i përgjegjësive për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së qiradhënies.		Pjesërisht Personi përgjegjës është caktuar por ende nuk janë konsoliduar të dhënat për borxhet dhe qiramarrësit.	
Obligimet	Drejtorët të vlerësojnë në baza mujore, të gjitha faturat e papaguara dhe në mënyrë formale raportojnë tek ZKF. Po ashtu, konfirmime formale duhet të sigurohen nga departamentet komunale se të gjitha faturat e papaguara i janë proceduar për pagesë shërbimit të financave		Pjesërisht ZKF nuk verifikon deklaratat e udhëheqësve të njësive me rastin e identifikimit të faturave të papaguara.	
Auditimi i brendshëm	Drejtorët t'u përgjigjen kërkesave për planifikim të AB, me fokus të veçantë, vlerësimin e ekspozimit ndaj rreziqeve përkatëse. Plani i auditimit për vitin 2016 të përfshijë trajtimin e subvencioneve.	Po		